



Datë: 04.09.2025
Numër Protokolli: 5986/2025

A.nr.874/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtar, me Sabile Avdyli- në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.874/2025 të datës 13.05.2025 të parashtruar nga ankuesi Sh.K, kundër organit të punësimit Komuna e Fushë Kosovës në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.09.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.874/2025, të datës 13.05.2025, e parashtruar nga ankuesi Sh.K, në atë mënyrë që **anulohet** Formulari i datës 26.02.2025 dhe 07.05.2025 lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2024.

II. Obligohet Kryetari i Fushë Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë rivlerësim të rezultateve në punë për ankuesin për periudhën 2024.

IV. Obligohen Kryetari i Fushë Kosovës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës, që të ndërmarrin çdo veprim administrativ në kuptim të zbatimit të këtij vendimi sikurse është përcaktuar në pikën II dhe III të këtij dispozitivi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Sh.K (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 13.05.202 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit të datës 26.02.2025 dhe formularit të datës 07.05.2025 për vlerësimin e rezultateve në punë nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës.” e papranueshme” me notë mesatare 1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 23.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në

ankesë tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 10.06.2025 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegjigji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 3144/2025 të datës 13.05.2025; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2024 i datës 26.02.2025; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2024 i datës 07.05.2025; Vendimi A.nr.351/2021 i datës 29.03.2023 i KPMSHCK; Vendimi A.nr.574/2023 i datës 10.05.2023 i KPMSHCK; Vendimi A.nr.54/2022 i datës 29.11.2024 i KPMSHCK-së; Planit Strategjik për Njësien e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Fushë Kosovës për periudhën 2024-2026; Planit Vjetor për Njësien e Auditimit të Brendshëm në Komunë e Fushë Kosovës për periudhën kohore 2024; Vendimi i datës 21.11.2023; Kopja e ID kartelës të ankuesit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 23.05.2025; Përgjigje në ankesë e datës 10.06.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Akt Emërimi i datës 01.07.2016 dhe raporti i punës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të Komunës për periudhën janar-dhjetor 2024.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës në pozitën Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm sipas Aktit të Emërimit të datës 01.07.2016.

Më tej nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, me datë 26.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2024 të cilin ankuesi e ka pranuar me datë 13.04.2025 lidhur me vlerësimin e përgjithshëm e ka vlerësuar me nivelin “ e papranueshme Nota e përgjithshme 1 .

Ankuesi, në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.02.2025 dhe vlerësimin e rezultateve në punë të datës 07.05.2025, për shkak shkeljes së ligjit material dhe të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, ashtu që i njëjti propozon aprovimin e ankesës si të bazuar dhe të bëhet rivlerësimi në bazë të komenteve të vlerësuarit për pakënaqësitë në vlerësimin e objektivave dhe aftësive.

Kolegji i Këshillit lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike administrative ju referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenit 52: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me

planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësit që ka në vartësi. 9. Përfundimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë (në fuqi deri më datë 03.10.2024) dhe Rregulloren (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë (e cila është e aplikueshme nga data 04.10.2024), e të cilat akte ligjore rregullojnë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë.

Në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit dhe nga analizimi i shkresave të lëndës, konstatohet se Kryetari i Fushë Kosovës, ankuesin e ka vlerësuar për tërë vitin 2024 por nuk ka specifikuar saktësisht periudhën kohore të vlerësimit të vitit 2024, mirëpo duke marrë parasysh se i njëjti ka qenë Mbikëqyrësi i ankuesit nga provat e bashkangjitura të lëndës nga ankuesi dhe organi i punësimit nuk kemi asnjë provë se ankuesi është ngarkuar me punë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Tutje, nga Formulari për Vlerësimin e Rezultateve të Punës, të datës 26.02.2025, të realizuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, i cili në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, rezulton se të njëjtin e ka vlerësuar me nivelin: E papranueshme e që sipas nenit 9 paragrafit 3 nën paragrafit 3.5 të Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, për nivelin “E papranueshme”, shprehimisht theksohet se: *është vlerësim që tregon se nëpunësi civil ka dështuar të përmbushë në mënyrë të dukshme dhe të përsëritur pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e tij. Performanca është shumë poshtë standardeve të përcaktuara dhe kërkohet veprim i menjëhershëm për përmirësim;*, mirëpo Kolegji i Këshillit, konstaton se ky Formular, përmban mangësi të theksuara, dhe është i përfshirë me shkelje të ligjit material, përkatësisht të dispozitave të Nenit 52 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, e cila përcakton rregullat, metodologjinë dhe procedurën për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil, ngase nga shkresat e bashkangjitura të lëndës nga organi i punësimit, fillimisht Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi mbi përcaktimin e objektivave individuale siç përcaktohet me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 52 të këtij Ligji dhe nenin 4 të kësaj Rregulloreje, ku shprehimisht theksohet se: *1. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunësit civil bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësin, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. Gjatë përcaktimit të objektivave, NJMBNJ siguron përfshirjen e trajnimeve të nevojshme për nëpunësin civil në planin individual të tij. 2. Plani individual i punës sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të rishikohet nga*

mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesi i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësin civil. 3. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë....., ndërsa po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton se është vepruar në kundërshtim edhe me nenin 52 paragrafin 11 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku theksohet: 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin;, sepse në asnjë prej rubrikave të këtij formulari të vlerësimit, nuk rezulton të jenë dhënë komente nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo arsyetim se pse është vlerësuar me nivelet përkatëse ankuesi, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njërës prej objektivave dhe detyrave të punës. si dhe ndër të tjera në kuptim të nenit 52 paragrafit 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 2. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët.; Kolegji i Këshillit, konstaton se është vepruar në kundërshtim me këtë përcaktim ligjor, ngase nga shkresat e bashkangjitura të lëndës nuk rezulton asnjë dëshmi se ankuesi është ftuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo përfaqësuesi/ja i/e Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të organit përkatës të punësimit, dhe se po ashtu ky Formular i Vlerësimit të Rezultateve të Punës i realizuar nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës nuk është nënshkruar nga të gjitha palët, siç edhe nuk është specifikuar as periudha e vlerësimit të ankuesit në formularin e datës 26.02.2025.

Mirëpo Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i lëndës ka konstatuar se asnjë raport i punës për vitin 2024 nuk është përcjell nga ankuesi për Kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës me arsyetimin se Mbikëqyrësi për 9 vite më ka vlerësuar tri herë në vitin 2016, 2022 dhe 2024.

Andaj, bazuar në konstatimet e më sipërme, duke qenë se Formulari i Vlerësimit të Rezultateve të Punës, i datës 26.02.2025, është i përfshirë me shkelje të dispozitave të ligjit material siç janë pasqyruar më sipër, si për rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, vendosi të anuloi Formularët e Vlerësimit të Rezultateve të Punës për vitin 2024, të ankuesit, me obligimin që Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për periudhën për vitin 2024 nga data 01.01.2024 deri më datë 31.12.2024, ku i njëjti ka qenë në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të tij, duke vepruar në pajtim me nenin 52 të Ligjit Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve të Punë

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.874/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Sh.K;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.